



AKSESI NË DREJTËSI: KËNDVËSHTRIMET DHE SFIDAT E QYTETARËVE

Raport bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga anketimi 'Observatori Qytetar' në gjykatat e qyteteve Elbasan, Shkodër, Pogradec, Korçë, Peshkopi, Durrës dhe Sarandë gjatë periudhës Maj 2017 – Janar 2018



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi i qytetarëve lidhur me aksesin në drejtësi", zbatuar nga Koalicioni "Drejtësi për të gjithë", nëpërmjet organizatës anëtare AWEN-Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri. Tiranë, Mars 2018.



TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e përmbajtjes	2
Lista e grafikëve	3
Mirënjohje	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	7
Metodologjia.....	9
GJETJET: Analiza e të dhënave	13
i. Nisja dhe natyra e proceseve gjyqësore	13
ii. Asistenca institucionale ndaj qytetarëve.....	16
iii. Informimi paraprak i qytetarëve.....	17
iv. Perceptimet dhe eksperiencat lidhur me procesin gjyqësor.....	19
v. Vlerësimi i qytetarëve rreth profesionistëve dhe shpenzimeve	22
Rekomandime	25
SHTOJCA 1. Observatori qytetar mbi aksesin në drejtësi	26



LISTA E GRAFIKËVE

- Grafik nr.1** Qyteti ku janë mbledhur të dhënat
- Grafik nr.2** Moshë e të anketuarve
- Grafik nr.3** Statusi civil
- Grafik nr.4** Statusi i punësimit
- Grafik nr.5** Statusi i veçantë
- Grafik nr.6** Natyra e gjykimit/çështjes
- Grafik nr.7** Pozicioni në çështjen gjyqësore
- Grafik nr.8** Pengesat në nisjen e një procesi gjyqësor
- Grafik nr.9** Përfaqësimi në gjykatë (me/pa avokat)
- Grafik nr.10** Lëshim vendimi nga gjykata
- Grafik nr.11** Asistenca institucionale në plotësimin e kërkesës
- Grafik nr.12** Informimi nga organet përkatëse për të drejtat gjatë procesit gjyqësor
- Grafik nr.13** Informimi nga organet përkatëse lidhur me procedurën gjyqësore
- Grafik nr.14** Informimi nga organet përkatëse për orën dhe datën e gjykimit
- Grafik nr.15** Informimi nga organet përkatëse për kundërshtimin e vendimit
- Grafik nr.16** Informimi nga organet përkatëse për tërheqjen e dosjes së aktit
- Grafik nr.17** Informimi nga organet përkatëse rreth ndihmës ligjore falas
- Grafik nr.18** Dijeni rreth OJF-ve që ofrojnë ndihmë ligjore falas
- Grafik nr.19** Kuptueshmëria e gjuhës së përdorur nga gjykata gjatë procesit
- Grafik nr.20** Nevoja për mbrojtje me avokat
- Grafik nr.21** Aftësia/mundësia për t'u shprehur gjatë seancave
- Grafik nr.22** Vlerësimi lidhur me zgjidhjen e çështjes nga gjykata
- Grafik nr.23** Vlerësimi i trajtimit të qytetarëve nga organet shtetërore
- Grafik nr.24** Vlerësimi i profesionistëve të përfshirë në proces
- Grafik nr.25** Vlerësimi i shpenzimeve të taksave gjyqësore



MIRËNJOHJE

Raporti **“Aksesi në drejtësi: këndvështrimet dhe sfidat e qytetarëve”** u përgatit nga AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” në kuadër të projektit *“Fuqizimi i qytetarëve lidhur me aksesin në drejtësi”*, zbatuar nga Koalicioni *“Drejtësi për të gjithë”*, AWEN dhe organizatat anëtare gjithashtu të përfshira në zbatimin e këtij projekti prej shumë vitesh punojnë në mbrojtje të drejtave të grave vulnerabël në 7 qarqe të Shqipërisë, duke ofruar edhe asistencë dhe mbrojtje ligjore për të mbijetuarat e dhunës dhe trafikimit.

Ky raport vjen si një përpjekje për të patur një panoramë më të qartë të sfidave që hasin çdo ditë qytetarët lidhur me aksesin në drejtësi, me fokus të veçantë qytetarët me vulnerabël dhe rrjedhimisht nevojave që kanë qytetarët në mënyrë që t’u garantohet akses më cilësor në drejtësi përmes nismave advokuese që lidhen me këto sfida. Gjetjet e këtij raporti do të përdoren për të çuar përpara përpjekjet për përmirësimin e legjislacionit dhe shërbimeve ligjore që marrin qytetarët, duke mbushur hendeqet dhe duke shtyrë përpara përmirësimin e situatës së aksesit në drejtësi.

AWEN dëshiron të falenderojë Koalicionin *“Drejtësi për të gjithë”* për besimin dhe mbështetjen në zbatimin e këtij projekti, si dhe ato organizata anëtare të AWEN – Gruaja tek Gruaja, Shkodër; Unë, Gruaja, Pogradec/ Korçë; Forumi Gruas Elbasan; Qendra për Vajza e Gra në Nevojë, Durrës; Qendra Psiko-Sociale ‘Vatra’ Vlorë; Shoqata ‘Jona’ Sarandë; Agritra- Vizion, Peshkopi - që mundësuan mbledhjen e të dhënave në terren, përmes angazhimit të juristëve të organizatave në plotësimin e pyetësorëve të observatorit, pranë gjykatave të rretheve ku ato punojnë. Falenderojmë gjithashtu të gjithë ata qytetarë që u bënë pjesë e procesit të anketimit dhe që ndanë me ne eksperiencat e tyre lidhur me aksesin në drejtësi.

Së fundmi, urojmë që gjetjet e këtij raporti të shërbejnë si bazë për nisma të reja advokuese e lobuese, në mbështetje të plotë të qytetarëve që aksesojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga të dhënat e mbledhura gjatë procesit të anketimit të qytetarëve përmes 'Observatorit Qytetar', u konstatua që sfidat dhe problematikat që hasen janë të shumëllojshme dhe të ngjashme në të gjitha bashkitë ku u zhvillua anketimi.

Disa nga gjetjet kryesore që dolën gjatë observatorit qytetar ishin:

- Lidhur me aksesin në drejtësi të qytetarëve, *pengesa e hasur më shpesh prej tyre është pamundësia financiare (36.1%).*
- Afro 1/4 e qytetarëve në proces gjyqësor *nuk përfaqësohen* në gjykatë me avokat mbrojtës. Pamundësia ekonomike nuk rezulton të jetë faktor domethënës nga ky anketim.
- Në të gjitha rastet kur ka pasur fëmijë minorenë, fëmijët janë asistuar nga një psikolog/e.
- Shumica dërrmuese e qytetarëve është informuar nga gjykata *lidhur me të drejtat që gëzojnë gjatë procesit gjyqësor* (vetëm 14% e tyre nuk ka marrë informacion), si dhe *lidhur me procedurën gjyqësore përpara ardhjes në gjykatë* (19% nuk ka marrë informacion);
- 9.4% e qytetarëve deklarojnë që *nuk janë lajmëruar në asnjë formë*, pra s'kanë marrë asnjë lajmërim lidhur me orën dhe datën e gjykimit.
- 1/5 e qytetarëve deklarojnë që *nuk kanë marrë informacion lidhur me të drejtën e qytetarit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës* lidhur me çështjen në gjykim.
- 31% e qytetarëve të anketuar deklarojnë që *nuk kanë informacion/ nuk u është komunikuar nga gjykata e drejta ligjore për marrjen e akteve të dosjes së tyre.*
- 71% e qytetarëve *nuk janë vënë në dijeni nga gjykata rreth të drejtës për ndihmë ligjore falas*, ndërsa 42% e qytetarëve shprehen se *janë në dijeni të shoqatave që mund të ofrojnë ndihmë ligjore falas.*
- Për rreth 1/4 e qytetarëve, *gjuha e përdorur nga gjykata ka qenë shumë e vështirë për t'u kuptuar*, pavarisht nëse kanë qenë apo jo të përfaqësuar me avokat mbrojtës.
- 17.8% shprehen se *nuk kanë shprehur aspak atë që donin* gjatë procesit gjyqësor.



- 3/4 e qytetarëve shprehen se *e kanë ndjerë të nevojshme praninë e një avokati mbrojtës gjatë procesit gjyqësor.*
- Një përqindje shumë e lartë e qytetarësh (43%) vlerëson se *vendimi i gjykatës nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare* kërkesës së tyre.
- Një përqindje e lartë e qytetarëve (rreth 31%) deklaroi se *nuk janë trajtuar me respekt, dinjitet dhe drejtësi nga organet shtetërore* të cilave i janë drejtuar për zgjidhjen e problemit të tyre (gjykata, prokuroria). Nuk rezultoi diferencë domethënëse në mënyrën e trajtimit mes burrave e grave, apo mes qytetarëve që kanë apo nuk kanë status të veçantë (paaftësi fizike, nevojë ekonomike).
- *Vlerësimin më të lartë për profesionalizëm nga qytetarët e anketuar e marrin sekretaria e seancës, sekretaria gjyqësore dhe avokati/ja* (afërsisht nga 7,3 pikë nga 10 pikë), ndërsa vlerësimin më të ulët e marrin prokurorët e çështjeve.
- *Shpenzimet për taksat gjyqësore, për avokat mbrojtës dhe për ekspert vlerësohen si të papërbalueshme nga mesatarisht 40% e qytetarëve të anketuar, me përqindje më të larta mes qytetarëve në nevojë ekonomike.*



HYRJE

Projekti në kuadër të të cilit është hartuar ky raport, zbatohet nga AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri në bashkëpunim me SSCI - Institutin e Europës Juglindore për Kontratën Shoqërore, një nga organizatat anëtare të Koalicionit: “Drejtësi për të Gjithë. Gjatë zbatimit të këtij projektit përpjekjet u përqëndruan në qëllimin e dytë strategjik të Koalicionit: Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për individët në nevojë dhe grupet e tilla si romët, gratë, fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, viktimat të trafikimit dhe të dhunës, LGBTI, etj.

Tre objektivat e kësaj ndërhyrjeje, sipas Planit të Veprimit të Koalicionit kanë qenë: Fuqizimi i grupeve të pafavorizuara përmes edukimit ligjor; Reduktimi i pengesave ligjore, ekonomike, dhe kulturore për aksesin në drejtësi të grupeve të pafavorizuara; Përmirësimi i zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje. Ky raport është një aktivitetet që ndihmon në realizimin e objektivit të dytë të projektit.

Objektivat në tërësi, u synuan të arrihen nëpërmjet: **i) aktiviteteve informuese dhe edukuese** nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit me grupe të ndryshme me të cilat punojnë organizatat anëtare të AWEN, si: gratë e varfra të pafavorizuara, gratë dhe vajzat rome, gratë viktimat të trafikimit, gratë viktimat të DhBGj dhe dhunës në familje, gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta, etj në lidhje me të drejtat e tyre sa i takon aksesin në drejtësi, pengesat ligjore, ekonomike dhe kulturore, si dhe në lidhje me rezultatet e monitorimit të kuadrit ligjor përkatës; **ii) Monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor** dhe vlerësimin e pengesave të aksesit në drejtësi, me qëllim identifikimin e problemeve në lidhje me nevojat e veçanta të grupeve të pafavorizuara; **iii) Avokimit për kompletimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor** për të adresuar çështjet kryesore në lidhje me nevojat e veçanta të grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet takimeve me institucionet zbatuese dhe vendimmarrëse, si dhe institucionet ndërkombëtare. Këto metoda ndërhyrëse sigurojnë arritjen e qëllimit strategjik, si rezultat i disa elementeve të forta strategjike, si: shtrirja e gjerë të informimit të publikut me fokus të veçantë në grupet e pafavorizuara, nëpërmjet 9 organizatave anëtare të AWEN të cilat kanë përvojë të gjerë në punën me grupet e pafavorizuara në zonat urbane dhe rurale; përvoja e mëparshme e anëtareve dhe AWEN në monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe vlerësimin/identifikimin e faktorëve frenues që vënë grupet në nevojë në një pozicion të vështirë në lidhje me aksesin në drejtësi; shtrirja e gjerë gjeografike e AWEN në 8 rrethe të vendit; Përdorimi i mediave audio-vizuale sidomos në nivel lokal nëpërmjet organizatave anëtare të AWEN



Lidhur me objektivin e dytë të ndërhyrjes, AWEN, nëpërmjet organizatave anëtare *synoi realizimin e një procesi vlerësimi nga vetë qytetarët nëpërmjet një pyetësori*, shpërndarjen e informacionit tek aktorët e përfshirë dhe adresimin e pengesave ligjore, ekonomike, dhe kulturore për akses në drejtësi të grupeve të pafavorizuara në nivel lokal dhe në nivel qendror përmes litigimit dhe avokimit, bazuar në gjetjet e dala nga observatori qytetar.

Qytetet ku u zbatua procesi i monitorimit janë: Elbasan, Durrës, Vlorë, Sarandë, Peshkopi, Shkodër, Pogradec, Korçë.

Gjetjet e këtij raporti janë të një rëndësie të veçantë kur bëhet fjalë për trajtimin e pengesave e problematikave kryesore për akses në drejtësi të grupeve të pafavorizuara. Shumë shpesh, disa nga pengesat vendosen nga strukturat vendore, së bashku me strukturat qendrore. Kjo është arsyeja pse litigimi i disa shqetësimeve në nivel lokal është shumë i rëndësishëm. Bazuar në gjetjet e këtij raporti, anëtarët e AWEN do të organizojnë takime avokuese me përfaqësues të institucioneve publike në nivel vendor, në çdo fushë të synuar. Disa struktura të synuara janë: gjykatat, prokuroria, shërbimet sociale, strukturat shëndetësore, njësitë administrative, komisariatet e policisë, etj. Mekanizmi i Referimit për Viktimat e Dhunës në Familje do të jetë një nga strukturat e targetuara, në lidhje me rolin e tyre në minimizimin e faktorëve që pengojnë viktimat e Dhunës në Familje të kenë akses në drejtësi. Qëllimi është informimi i të gjitha institucioneve relevante në rolin e tyre të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit në drejtësi për grupet e pafavorizuara, duke shmangur pengesat e raportuara/vëzhguara.

Në nivel qendror, përpjekjet avokuese do të ndjekin axhendën e Koalicionit: "Drejtësi për të Gjithë". AWEN dhe organizata anëtare do të jetë pjesë e të gjitha nismave për të adresuar çështjet e dala nga ky proces.



METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është të sigurojë një tablo të qartë të problematikave që prekin qytetarët që aksesojnë sistemin tonë të drejtësisë në 8 gjykata të vendit (Durrës, Vlorë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Sarandë, Peshkopi, Shkodër), si dhe të masë në terma sasiorë frekuencën me të cilën hasen problematika e vështirësi nga qytetarët.

Ky kapitull ofron një këndvështrim të shkurtër mbi metodën e përdorur, në funksion të objektivave dhe qëllimit të vlerësimit, duke përshkruar popullatën e tij, metodat e analizës së të dhënave, konsideratat etike dhe kufizimet e tij.


Tipologjia e hulumtimit - Ky raport vlerësues synon të arrijë objektivat e sipërmendur, nëpërmjet analizës dytësore të të dhënave statistikore, bazuar në pyetësorët e plotësuar nga qytetarët në proces gjyqësor, në 8 gjykata të vendit (Durrës, Vlorë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Sarandë, Peshkopi, Shkodër).

Instrumentet kërkimore dhe mbledhja e të dhënave - Analiza e të dhënave mbi aspekte dhe faza të ndryshme të aksesit në drejtësi, kryesisht në procese gjyqësore pranë gjykatave të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë karakteristika të ndryshme të të anketuarve (gjinia, vendbanimi, pa/aftësia fizike apo mendore, statusi social-ekonomik, etj). Kampioni i vlerësimit, ishin qytetarë që aktualisht (në momentin e mbledhjes të të dhënave) ishin të përfshirë në procese gjyqësore në 8 gjykatat e synuara.

Pyetësori u administrua nga jvistë të vendosur pranë gjykatave pranë këndeve Informuese të ngritura nga organizatat anëtare të AWEN në kuadër të këtij projekti. Pyetësori i shpërndarë mbledhi disa të dhëna sasiorë dhe cilësorë lidhur me problematikat kryesore që prekin qytetarët gjatë procesit të aksesit në drejtësi, si: *procedurën gjyqësore përpara ardhjes në Gjykatë; aksesin në informacion rreth procesit gjyqësor; detaje rreth procesit të gjykimit; pa/kënaqësia me vendimin e gjykatës; njohja e legjislacionit lidhur me çështjen në gjykim; vështirësitë në paraqitjen e provave dhe pretendimeve; vështirësitë financiare në përballimin e shpenzimeve gjyqësore; trajtimi nga organet shtetërore të përfshira dhe sjellja e pjesëmarrëve në procesin gjyqësor; përfaqësimi në gjykatë, aksesin në ndihmë ligjore falas; etj.* Për më shumë shihni pyetësorin bashkangjitur si shtojcë e këtij raporti.




Popullata e hulumtimit - Popullata që u konsultua për të dalë me gjetjet e këtij raporti ishin 629 qytetarë që vullnetarisht u bënë pjesë e anketimit në 8 gjykatat e synuara. Mbledhja e të dhënave ka qenë e shpërndarë në përqindje afërsisht të njëjta për çdo qytet të synuar (grafik 1).



Grafik nr.1

Afërsisht $\frac{1}{4}$ e të anketuarve (25%) i përkasin grupmoshës 59-70 vjeçare, ndërkohë që ka një prezencë gati të barabartë mes grupmoshave 49-58 vjeç, 39-48 vjeç dhe 29-38 vjeç (21%, 19%, 19% respektivisht). Qytetarët e anketuar të grupmoshës 18-28 vjeç janë ata më të paktët në numër në popullatën e studimit (16%). (Grafik 2)




Grafik nr.2




Balanca gjinore mes të anketuarve rezulton e arrirë me sukses, me një diferencë prej vetëm 4% mes **përfaqësimit të dy gjinive**. Në total ka 31 me shumë femra të anketuara sesa meshkuj gjatë observatorit qytetar në gjykata. Lidhur me të dhënat demografike, u mblodh informacion edhe rreth **vendbanimit** të të anketuarve, nga ku rezultoi se 2/3 e popullatës banonin në qytet, ndërsa pjesa tjetër në zonat rurale të bashkive të synuara.

Nga grafiku nr.3 më poshtë, mësojmë se pjesa më e madhe e të anketuarve, 63,4% deklarojnë se janë të martuar, afërsisht 20% të pamartuar dhe rreth 13% të divorcuar. Të dhënat rreth statusit të punësimit të të anketuarve (Grafik 4) tregojnë që numri i personave të punësuar dhe atyre të papunë është pak a shumë i njëjtë për të dy kategoritë, ndërkohë 9.9% e popullatës së anketuar është në moshë pensioni.




Grafik 3



Grafik 4

Për ne ishte me interes të mblidhnim informacion edhe rreth faktorëve të vulnerabilitetit (paaftësi fizike/ mendore, në nevojë ekonomike/ etj) të personave të anketuar (Grafik 5). Ndërkohë që 76,6% e të anketuarve nuk deklarojnë të bëjnë pjesë në ndonjë kategori vulnerabiliteti, afro 20% e tyre deklarojnë se janë në situatë të vështirë financare (nevojë ekonomike) dhe vetëm 3,7% vuajnë nga paaftësi fizike.



Grafik 5

Konsideratat etike - Në ndjekje dhe respektim të parimeve etike, në të gjitha rastet u informuan të intervistuarit rreth kontributit që pritej prej tyre. Subjekteve të vlerësimit iu bë e qartë se pjesëmarrja e tyre nuk ishte e detyrueshme dhe ishte e drejta e tyre për të mos marrë pjesë apo për t'u tërhequr nga anketimi në çdo kohë, apo edhe e drejta për të mos iu përgjigjur pyetjeve që mund të ishin të ndjeshme për ta.

U tregua shumë kujdes në respektimin e konsideratave etike, si: *fshehtësia dhe mirëbesimi i plotë* – të dhënat e marra për qëllimin e këtij vlerësimi u trajtuan në formë anonimi dhe në mirëbesim të plotë dhe nuk u përdorën për qëllime të tjera, përveç atij të shpallur.

Kufizimet - Ky raport nuk merr përsipër të përgjithësojë gjetjet e tij përtej grupit të synuar të studiuar. Të gjitha mendimet e ndara nga subjektet e këtij vlerësimi, janë ruajtur në formën e tyre origjinale dhe nuk mund të përgjithësohen përtej rasteve të studiara. Konkretisht, AWEN është i ndërgjegjshëm në lidhje me kufizimet e këtij studimi, që burojnë nga vështirësia e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave në nivel më të gjerë.




GJETJET: ANALIZA E TË DHËNAVE

Më poshtë gjeni të përshkruara gjetjet e anketimit, të ndara në 5 nëntema për lehtësi interpretimi e kategorizimi.

- i. Nisja dhe natyra e proceseve gjyqësore
- ii. Asistenca institucionale ndaj qytetarëve
- iii. Informimi paraprak i qytetarëve
- iv. Perceptimet dhe eksperiencat lidhur me procesin gjyqësor
- v. Vlerësimi i qytetarëve rreth profesionistëve dhe shpenzimeve

i) Nisja dhe natyra e proceseve gjyqësore


Gjatë anketimit u mblodh informacion rreth hallkave dhe momenteve të ndryshme të procesit gjyqësor, për të pasur një të kuptuar sa më të qartë të eksperiencave të qytetarëve në gjykatat e synuara. Sipas informacionit të dhënë nga qytetarët e anketuar (Grafik 6), rezulton se 1/2 e çështjeve në gjykim/të gjykuara në të cilat ata janë të përfshirë janë çështje civile, 20% e tyre janë çështje penale, 22% çështje familjare dhe 7% çështje tregtare.




Grafik 6



Të anketuarit u pyetën edhe rreth pozicionit të tyre në çështjet gjyqësore. 64% e tyre janë në pozita paditëse, 23% janë të paditur, ndërkohë që të pandehur dhe të dëmtuar nga vepra penale janë 3% e qytetarëve respektivisht (Grafik 7).




Nisja e një procesi gjyqësor shpesh është një sfidë e madhe për qytetarët, që nis me plotësimin e kërkesës për t'ju drejtuar gjykatës, ndërkohë që mund të ndeshen një sërë pengesash/frenuesish të tjerë. Të pyetur rreth vështirësive që ata kanë pasur gjatë procesit të vendimmarrjes për nisjen e procesit, vërejmë se pengesat e hasura më shpesh nga qytetarët që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje janë pamundësia financiare (36.1%), mungesa e besimit në një zgjidhje të drejtë (8.7%), si dhe frikë/presion në masën 7.6%. ¼ e qytetarëve raporton që nuk kanë pasur asnjë pengesë specifike.



Grafik 8




Lidhur me përfaqësimin e qytetarëve të anketuar në gjykim (grafik 9), 71.4% e tyre deklarojnë se janë përfaqësuar nga një avokat dhe 23.2% kanë mbrojtur çështjen e tyre pa praninë e një avokati. Rreth 3% janë asistuar nga familjarë gjatë procesit.



Grafik 9

Me interes ishte edhe mbledhja e informacionit rreth vendimit të gjykatës për çështjen gjyqësore (grafik 10), përveç procesit në tërësi (trajtuar në nëntemat e mëposhtme të seksionit të gjetjeve). Qytetarët raportojnë se në 62% të rasteve kërkesa u pranua, në 20% të rasteve është rrëzuar, në 9% të rasteve është pushuar dhe po në 9% është në proces.




Grafik 10



ii) Asistenca institucionale ndaj qytetarëve

Plotësimi i kërkesës për t'ju drejtuar gjykatës është hallka e parë për nisjen e një procesi gjyqësor. Shpesh plotësimi i kësaj kërkesë është i vështirë për t'u bërë me saktësi, ndaj nga eksperiencia e juristëve të organizatave të AWEN dimë që në shumicën e rasteve qytetarët zgjedhin të asistohen nga avokatë gjatë protësimit të kërkesës. Rezultatet e anketimit tonë (grafik 11) konfirmojnë të njëjtën tendencë, me 68% të të anketuarve që plotësojnë kërkesën me anë të një avokati, ndër të cilët 8.7% janë asistuar nga një avokat i shtetit dhe të tjerët nga avokati i pajtuar prej tyre. 16.5% e qytetarëve e kanë plotësuar vetë kërkesën për t'ju drejtuar gjykatës, 6.8% janë asistuar nga persona të tretë, ndërsa 7.2% e tyre janë asistuar nga një shoqatë/ ojf.




Grafik 11

Një faktor shumë i rëndësishëm gjatë proceseve gjyqësore është edhe **asistenca e ofruar për mbrojtjen e fëmijëve** në rastet kur ata janë pjesë e çështjes në gjykim. Në 64% të çështjeve në të cilat ishin të përfshirë të anketuarit ka patur fëmijë të përfshirë dhe rezulton që *në të gjitha rastet kur ka pasur fëmijë minorene fëmijët janë asistuar nga një psikolog/e*, duke respektuar kështu detyrimin ligjor për trajtimin e rasteve ku janë të përfshirë fëmijë nën 18 vjeç.




iii) Informimi paraprak i qytetarëve

Akresi në drejtësi i qytetarëve dhe cilësia e shërbimit të marrë nga gjyqësori janë të lidhura ngushtë me aksesin e tyre në informacion. Informacioni lidhur me të drejtat e qytetarit, procedurat për t'u ndjekur, detyrimet që të gjitha palët kanë gjatë/pas një procesi gjyqësor janë kyç për nisjen dhe përfundimin e procese gjyqësore konform ligjit. Një ndër detyrimet e gjykatës të cilës i drejtohet qytetari është **informimi për të drejtat e tij/saj gjatë procesit gjyqësor**. Vetëm 14% e qytetarëve të anketuar raporton se nuk ka marrë informacion nga gjykata lidhur me të drejtat që ai/ajo gëzon gjatë procesit gjyqësor (grafik 12). Të pyetur nëse a kanë pasur/marrë **informacionin e mjaftueshëm lidhur me procedurën gjyqësore** përpara ardhjes në gjykatë, 81% e qytetarëve të anketuar deklarojnë që e kanë marrë një informacion të tillë (grafik 13).




Grafik 12



Grafik 13

Mënyra e lajmërimit të qytetarit nga gjykata lidhur me orën dhe datën e gjykimit që rezultojnë të jetë më e përhapur është nëpërmjet fletëthirrjes (46,9%). Lajmërimi nëpërmjet avokatit mbrojtës është mënyra e dytë më e konstatuar nga qytetarët e anketuar (26,9%), ndërsa 9,2% deklarojnë se janë lajmëruar nëpërmjet telefonit. Ndërkohë që vetëm 3,2% janë lajmëruar nëpërmjet sistemit online, 9.4% e qytetarëve deklarojnë që nuk janë lajmëruar në asnjë formë, pra s'kanë marrë asnjë lajmërim lidhur me orën dhe datën e gjykimit (grafik 14).




Grafik 14

Ndër të tjera, informacion kyç është edhe infomimi lidhur me të drejtën e qytetarit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës lidhur me çështjen në gjykim. 1/5 e qytetarëve deklarojnë që nuk kanë marrë informacion lidhur më këtë të drejtë të tyre (grafik 15). Një nga të drejtat e tjera të qytetarëve është ajo e marrjes së akteve të dosjes së tyre. Është për t'u shqetësuar nga fakti që 31% e tyre deklarojnë që nuk janë në dijeni të kësaj të drejte, pra nuk i është komunikuar nga gjykata kjo e drejtë (grafik 16).




Grafik 15



Grafik 16



E drejta për ndihmë ligjore falas, në kushtet kur qytetarët deklarojnë se kanë vështirësi të përballojnë pajtimin e një avokati për mbrojtjen e çështjes së tyre, është një e drejtë që garantohet me ligj, nëse ai plotëson kushtet dhe dokumentacionin përkatës për përfitimin e këtij lehtësimi. Nga anketimi i observatorit tonë qytetar (grafik 17) rezulton se 71% e qytetarëve nuk janë vënë në dijeni nga Gjykata rreth kësaj mundësie. Gjithashtu qytetarët u pyetën nëse janë në dijeni të shoqatave që mund të ofrojnë ndihmë ligjore falas për ata persona që kanë nevojë për këtë shërbim, por nuk janë në kushtet për ta përballuar një avokat (grafik 18). 42% e qytetarëve shprehen se janë në dijeni të këtij fakti, që është një përqindje relativisht e lartë.




Grafik 17



Grafik 18


iv) Perceptimet dhe eksperiencat lidhur me procesin gjyqësor

Proceset gjyqësore janë eksperiencë të reja për shumë qytetarë dhe nëse ata s'kanë informacionin apo asistencën e duhur këto eksperiencë mund të jenë të vështira dhe të paqarta për ta. Gjuha që përdor gjykata gjatë procesit gjyqësor për 23% të qytetarëve ka qenë shumë e vështirë për t'u kuptuar, konstatim që shpreh nevojën për më shumë qartësi dhe thjeshtësi në të shprehur gjatë proceseve gjyqësore. Kjo përqindje është e përafërt për të gjithë qytetarët, pavarësisht nëse kanë qenë apo jo të përfaqësuar me avokat mbrojtës (grafik 19).



Grafik 19


$\frac{3}{4}$ e qytetarëve shprehen se e kanë ndjerë të nevojshme praninë e një avokati mbrojtës gjatë procesit gjyqësor, ndërsa vetëm 21% e tyre deklarojnë që nuk e kanë ndjerë të nevojshme. Qytetarët që nuk janë përfaqësuar me avokat mbrojtës në gjykatë rezultojnë ta kenë ndjerë të nevojshme praninë e avokatit në përqindje më të lartë krahasuar me qytetarët e pajisur me avokat mbrojtës (54.1% kundrejt 45.9%). Edhe qytetarët e përfaqësuar nga familjarët e tyre (3% e totalit) shprehen se e kanë ndjerë këtë nevojë (78.4% e tyre). E njëjta tendencë (nevojë për avokat) vihet re edhe mes 81% të qytetarëve që kanë qenë të pajisur me avokat.



Grafik 20




Qytetarëve duhet t'u jepet mundësia për të shprehur mendimin e tyre për problemin që ata po përpiqen të zgjidhin nëpërmjet gjykatës. Nga observatori qytetar (grafik 21) rezulton se 25.8% e tyre kanë arritur të shprehin shumë mirë atë që donin gjatë procesit gjyqësor, ndërsa 55.3% deklarojnë se janë shprehur mjaftueshëm. 17.8% shprehen se nuk kanë shprehur aspak atë që donin dhe të dhënat na tregojnë që mes qytetarëve që nuk kanë qenë të mbrojtur me avokat, vetëm 18.6% e tyre e bëjnë një deklaram të tillë, përqindje kjo shumë pak më e lartë se qytetarët që kanë qenë të mbrojtur me avokat (17.2%). Vetëm 20% e qytetarëve shprehen se kanë pasur vështirësi në paraqitjen e provave dhe pretendimeve të tyre para gjykatës.



Grafik 21

Gjysma e popullatës së anketuar deklaroi se vendimi i dhënë i ka dhënë një zgjidhje përfundimtare kërkesës së tyre, ndërsa një përqindje shumë e lartë e qytetarëve (43%) vlerësoi se vendimi i gjykatës nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare kërkesës së tyre.



Grafik 22

v) Vlerësimi i qytetarëve rreth profesionistëve dhe shpenzimeve


Një përqindje e lartë e qytetarëve (rreth 31%) deklaroi se nuk janë trajtuar me respekt, dinjitet dhe drejtësi nga organet shtetërore të cilave i është drejtuar për zgjidhjen e problemit të tyre (gjykata, prokuroria). Parë në këndvështrimin gjinor, një përqindje pak më e lartë e burrave (16.1% kundrejt 14.5%) të anketuar raportojnë të mos jenë



trajtuar me respekt, dinjitet e drejtësi nga organet shtetërore. Ndërsa, nëse i referohemi statusit të veçantë të qytetarëve (paaftësi fizike dhe në nevojë ekonomike), rezultoi që nuk ka diferencë domethënëse në mënyrën e trajtimit mes qytetarëve që nuk kanë status të veçantë. (Grafik 23)



Qytetarëve në bashkitë e synuara, pjesë të këtij observatori qytetar, iu kërkua të bënin një **vlerësim të performancës e profesionalizmit të disa aktorëve** kyç (sekretaria e seancës, gjykatësin, avokatin, sekretarinë gjyqësore, prokurorin, ekspertin) gjatë gjithë procesit gjyqësor që ata janë duke kaluar apo kanë përfunduar. Ndërkohë që asnjë nga qytetarët nuk jep pikë maksimale për asnjë nga profesionistët gjyqësorë, vlerësimin më të lartë (afërsisht nga 7,3 pikë nga 10 pikë) e marrin sekretaria e seancës, sekretaria gjyqësore dhe avokati/ja. Jo shumë dobët vlerësohen gjykatësit/et (6.5 pikë), me 5.5 pikë eksperti/ja. Vlerësimin më të ulët nga qytetarët e marrin prokurorët e çështjeve, që shihen si profesionistët me performancë më të dobët se gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në procese gjyqësore.




Grafik 24

Shpenzimet lidhur me proceset gjyqësore janë një çështje që shpesh shqetësojnë qytetarët, sidomos ata më vulnerabël. Ne ishim të interesuar të kuptonim se cili ishte vlerësimi i tyre për disa shpenzime të paevitueshme për nisjen dhe përfundimin e një procesi gjyqësor. Ndërkohë që pak më shumë se gjysma e qytetarëve i vlerëson shpenzimet për taksat gjyqësore (grafik 24) të përballeshme ose normale, 41.7% e tyre i vlerësojnë si shumë të larta, pra të



papërbalueshme. Nga të dhënat rezulton se nuk ka ndonjë dallim domethënës në përqindje mes qytetarëve në nevojë dhe atyre pa status të veçantë.



Grafik 25

Shpenzimet për avokat mbrojtës dhe për ekspertin vlerësohen gjithashtu si të papërbalueshme nga respektivisht 40% e qytetarëve të anketuar, me përqindje më të larta mes qytetarëve në nevojë ekonomike vetëm për shpenzimet për avokatin (45% e qytetarëve në nevojë ekonomike).



REKOMANDIME

- Bazuar në vlerësimin e të gjitha gjetjeve të dala nga procesi i mbledhjes së të dhënave në terren dhe në rekomandimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të dala nga të intervistuarit, rekomandimet kryesore të dala janë:
- Të rishikohen tarifat e detyrueshme gjyqësore për kategoritë në nevojë të cilat përjashtohen edhe nga taksat kombëtare.
- Krijimi i mundësisë për mbrojtje ligjore falas për kategoritë në nevojë, përmes rritjes së informacionit për përfitimin dhe rëndësinë e përfaqësimit në gjykim me mbrojtës ligjor.
- Të përshpejtohet informimi i qytetarëve nga gjykatat për të drejtën e tyre për përfitimin e ndihmës ligjore falas, siç parashikohet në ligjin për ndihmë ligjore falas (i cili hyn në fuqi në Qershor 2018)
- Të garantohet asistenca dhe vlerësimi psikologjik i të miturve në çdo etapë të hetimit dhe gjyimit përmes specialistëve të fushës së psikologjisë, siç parashikohet në Kodin e Drejtësisë për të Miturit.
- Të përmirësohet procedura e informimit të qytetarëve mbi të drejtën e ankimimit të vendimeve dhe afateve të tyre, si dhe gjykatës të cilës duhet t'i drejtohet.
- Të përmirësohet teknika legislative gjatë procesit gjyqësor për të qenë më e kuptueshme dhe efikase për qytetarin.
- Të krijohen mundësi për edukimin e qytetarëve mbi mënyrën e dhënies së shpjegimeve dhe fakteve në gjykatë, dhe nga gjykata t'u krijohet mundësi qytetarëve të sqarojnë detaje e rrethana thelbësore dhe që i shërbejnë çështjes, pavarësisht nëse janë të përfaqësuar apo jo me avokat mbrojtës.
- Të përmirësohet hartimi i vendimeve gjyqësore duke mos anashkaluar shkakun dhe qëllimin që palet ndërgjygjëse paraqesin në proceset gjyqësore.
- Të përmirësohet ndërveprimi me prokurorët e çështjes në respektim të dinjitetit, të drejtave dhe lirive të qytetarëve.
- Zbutja dhe publikimi i tarifave të ekspertëve dhe avokatëve, për kategoritë në nevojë që provojnë kufizimet ekonomike, për t'ju përgjigjur detyrimeve financiare të nevojshme gjatë procedurave gjyqësore.



SHTOJCA 1. OBSERVATORI QYTETAR MBI AKSESIN NË DREJTËSI

Ky pyetësor është përgatitur në kuadër të një projekti me fokus aksesin e qytetarëve në drejtësi, zbatuar nga AËEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri në bashkëpunim me organizatat anëtare në 8 Qarqe të Shqipërisë, dhe mbështetur nga Koalicioni “Drejtësi për të Gjithë”. Përmes këtij pyetësori synohet mbledhja e informacionit nga vetë qytetarët lidhur me eksperiencën e tyre në sistemin gjyqësor. Gjetjet e dala do të përdoren për hartimin e një raporti të përmbledhur me vëmendje të veçantë tek sfidat dhe vështirësitë e hasura nga qytetarët gjatë proceseve gjyqësore. Raporti i prodhuar do të përdoret për të advokuar në nivel vendor e qendror lidhur me përmirësimin e cilësisë së aksesit në drejtësi të qytetarëve.

Të dhënat e mbledhura do të trajtohen në anonimat, ndaj nuk është e nevojshme të shkruani emrin tuaj. Një specialist ligjor i shoqatës do t’ju orientojë dhe asistojë në plotësimin e pyetësorit. Ju falenderojmë paraprakisht për kontributin tuaj me vlerë!

TË DHËNA PERSONALE

Mosha Juaj: 18-28 vjeç 28-38 vjeç 38-48 vjeç 48-58 vjeç 58-70 vjeç

Gjinia: Femër Mashkull **Statusi i punësimit:** _____ **Profesioni:** _____

Vendbanimi Qytet Fshat **Statusi civil:** _____

Status i veçantë (paaftësi fizike/ mendore, në nevojë ekonomike/ etj _____

1. A mund të përcaktoni natyrën e gjykimit të çështjes tuaj gjyqësore ?

-Civile - Penale - Familjare -Tregtare

2. Cili ishte pozicioni juaj në procesin gjyqësor?(nëse dëshironi të jepni të dhënat tuaja)

-Paditës - I paditur - I pandehur - I dëmtuar nga vepra penale - Familjar

3. Kush ju ndihmoi në plotësimin e kërkesës për t’ju drejtuar Gjykatës?

-Avokati i pajtuar nga ju -Avokat shteti - Vetë -Një shoqatë -Të tjerë

4. A u informuat për procedurën gjyqësore përpara ardhjes në Gjykatë?

a) Po b) Jo



Nëse, po, ku konsistonte informacioni që morët ?

- a) Formën e aktit që do paraqes në gjykatë
- b) Në orarin e gjykimit
- c) Në mënyrën e njoftimit
- d) Në vendimin që do lëshonte Gjykata
- e) Të gjithë informacionin
- f) Asnjëra nga këto
- g) Të tjera

5. Si u lajmëruat për orën dhe datën e gjykimit ?

- a) Përmes telefonit
- b) Përmes Avokatit
- c) Me fletëthirrje
- d) Asnjë lajmërim
- e) Përmes sistemit online të Gjykatës
- f) Të tjera

6. A patët vështirësi për të ardhur në orar në Gjykatë ?

- a) Po b) Jo

7. Sa kohë zgjati pritja juaj për të filluar gjykimi ?

- a) Në kohë b) Deri në 15 min c) Deri në 30 min d) Më shumë se 30 min

8. Çfarë pritshmëri keni nga vendimi që ka dhënë /do të japë Gjykata?

- a) Asnjë pritshmëri b) të mira c) të këqija d) nuk prononcohem

9. Nëse keni qenë pjesë në procese gjyqësore të tjera, vendimi i marrë ka qenë ;

- a) Në favorin tuaj: Asnjë vendim Një vendim Më shumë se 1 vendim

- b) Kundër jush: Asnjë vendim Një vendim Më shumë se 1 vendim

10. A mendoni që vendimi i Gjykatës i ka dhënë zgjidhje përfundimtare kërkesës (shqetësimi problem) tuaj? Jepni sygjerimin tuaj



a) Po b) Jo

11. Gjuha e folur që përdori Gjykata gjatë procesit a ishte e kuptueshme nga ju? Jepni shpjegime pse .

a) E lehtë për t'u kuptuar b) shumë e vështirë për t'u kuptuar nga unë

12. A ju informoi Gjykata për të drejtat tuaja gjatë procesit gjyqësor ?

a) Po b) Jo

13. Gjatë seancave arritët të shprehnit gjithçka që mendonit për problemin tuaj në Gjykatë? Nëse nuk jeni dëgjuar gjatë procesit, shpjegoni arsyen pse .

a) Aspak b) Mjaftueshëm c) Shumë mirë

14. A keni marrë këshilla nga nënpunësit për mënyrën si duhet të silleni në Gjykatë ?

a) Aspak b) Mjaftueshëm c) Shumë mirë Tjetër _____

15. A lëshoi Gjykata një vendim për ju?

a) U pushua b) U rrëzua c) U pranua

16. A keni informacion mbi legjislacionin përkatës rreth çështjes tuaj ?

a) Nuk kam b) Pak c) Mjaftueshëm d) Shumë mirë

17. A hasët vështirësi në paraqitjen e provave dhe pretendimeve tuaja para Gjykatës ?

a) Po b) Jo

Nëse po a mund të listoni 3 pengesa ?

a) _____ b) _____ c) _____

18. A keni hasur probleme/vështirësi në vendimin tuaj për të nisur një proces gjyqësor?

a) Po b) Jo

Nëse po, ç'lloj pengese keni hasur?

a) Mungesë informacioni mbi ligjin b) Pamundësi financiare c) Frikë/presion

d) Mungesë mbështetje nga familja e) Mungesë besimi për zgjidhje të drejtë



f) Tjetër _____

19. U përfaqësuar vetë në gjykim apo me avokat mbrojtës?

a) Vetë b) Me avokat mbrojtës c) Familjarë

20. A e ndjetë të nevojshme praninë e një mbrojtësi gjatë gjyqimit tuaj ?

a) Po b) Jo

21. Si i vlerësoni shpenzimet e detyrueshme gjyqësore?

Taksa gjyqësore: Të papërballueshme Të përshtatshme Normale

Pagesë avokati: Të papërballueshme Të përshtatshme Normale

Pagesë eksperti: Të papërballueshme Të përshtatshme Normale

22. A e keni ndjerë veten nën presion për shpenzime të tjera jashtë gjyqësore gjatë vijueshmërisë së procesit ?

a) Po b) Jo

Nëse po nga kush ka ardhur ky presion? _____

23. A jeni vënë në dijeni nga Gjykata për mundësinë e përfitimit të mbrojtjes ligjore falas? Jepni shpjegime nëse po.

a) Po b) Jo

24. A jeni trajtuar me respekt, dinjitet dhe drejtësi nga të gjithë organet shtetërore që ke kontaktuar për zgjidhjen e problemit tuaj? Jepni shpjegime.

a) Po b) Jo

25. Përcakto nivelin e sjelljes të pjesëmarrësve në procesin gjyqësor ndaj jush, nga 1 deri në 10 (ku 1 është "keq" dhe 10 "shumë mirë"):



- | | | | |
|------------------------|--------------------------|------------------------|--------------------------|
| - Sekretari i seancës | <input type="checkbox"/> | - Prokurori i çështjes | <input type="checkbox"/> |
| - Gjykatësi | <input type="checkbox"/> | - Pala kundërshtare | <input type="checkbox"/> |
| - Sekretaria gjyqësore | <input type="checkbox"/> | - Ekspertët | <input type="checkbox"/> |
| - Avokati/ët | <input type="checkbox"/> | | |

26. A kanë qenë fëmijët tuaj pjesë e procesit gjyqësor?

- a) Po b) Jo

Nëse po a janë asistuar me ekspert psikolog?

27. A jeni në dijeni të të drejtës tuaj për të marrë akte të dosjes tuaj?

- a) Po b) jo

28. A jeni informuar për të drejtën tuaj për të kundërshtuar vendimin e gjykimit?

- a) Po b) Jo

29. A keni dijeni që ekzistojnë shoqata që ofrojnë ndihmë ligjore falas për personat në nevojë?

- a) Po b) Jo

Faleminderit për kohën!